



**UNMIK**

**MEM**

MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE  
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA,  
MINISTRY OF ENERGY AND MINING



**IPVQ**

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA**

**Ministria e Energjisë  
dhe Minierave**

**Ministry of Energy and  
Mining**

**Ministarstvo Energije i  
Rudarstva**

## **Plani i Propozuar për Implementimin e Acquis mbi Mjedis të TKE-EJL**

**Maj 2007**

## Shkurtesat

AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
VNM	Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
UE	Unioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
IMD	Direktiva e Impianteve të Mëdha Djegëse
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MM	Memorandumi i Mirëkuptimit
TKE – EJL	Traktati i Komunitetit të Energjisë – Evropa Jug Lindore
UNMIK	UNMIK-u

## Përmbajtja

Përmbledhja Ekzekutive	<a href="#">iii</a>
1 Hyrje	1
2 Situata Aktuale e Legjislacionit të Mjedisit në Kosovë	2
3 Direktiva e Këshillit 1999/32/EC të datës 26 Prill 1999 (Direktiva e Sulfurit)	3
3.1 Gjeneral	3
3.2 Obligimet bazë	4
3.3 Implementimi i Direktivës në Kosovë	5
3.4 Detyrat kryesore për implementim	8
3.5 Afati Kohor Indikativ	9
4 Direktiva e Këshillit 2001/80/EC të datës 23 Tetor 2001 (Direktiva e IMD-së)	11
4.1 Gjeneral	11
4.2 Obligimet e IMD-së	11
4.3 Implementimi i Direktivës së IMD-së në Kosovë	14
4.4 Detyrat kryesore për implementim	17
4.5 Afati Kohor Indikativ	21
5 Direktiva e Këshillit 79/409/EC të datës 2 Prill 1979 (Direktiva e Zogjve të Egër)	23
6 Konkluzione	24
Shtojcat	
Shtojca I: Kreu i Mjedisit të TKE-EJL	26
Shtojca II: Afati Kohor për implementimin e Acquis mbi Mjedisin	27
Shtojca III: Memorandumi i Mirëkuptimit MEM - MMPH	28
Shtojca IV: Sugjerimet për bashkëpunim struktural në mes të MEM-it dhe MMPH-së	29
Shtojca V: Shënim i shkurtër Sekretarit të Përhershëm të MEM-it	31

## Përmbledhja Ekzekutive

TKE-EJL cakton afatin kohor specifik për implementimin e disa direktivave lidhur me mjedisin.

Direktiva e BE-së	Koha
1. Direktiva e Këshillit 85/337/EC të datës 27 Qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private për mjedisin (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis)	Me hyrjen në fuqi të Traktatit
2. Direktiva e Këshillit 1999/32/EC të datës 26 Prill 1999 lidhur me reduktimin e përmbajtjes së sulfurit në karburantet e caktuara të lëngëta	Deri me 31 Dhjetor 2011
3. Direktiva e Këshillit 2001/80/EC mbi limitimin e emetimeve të ndotësve të caktuar në ajër nga Impiantet e Mëdha Djegëse	Deri me 31 Dhjetor 2017
4. Të implementohet Neni 4(2) të Direktivës së Këshillit 79/409/EC të datës 2 Prill 1979 mbi rruajtjen e zogjve të egër.	Me hyrjen në fuqi të Traktatit

Direktiva NMV e përmendur nën artikullin 1 tanimë është implementuar në Kosovë. Veprimi i mëtejshëm lidhur me implementimin e nenit 4 (2) të Direktivës mbi Zogjtë e Egër nuk është soditur apo menduar nga MEM-i dhe iu është mbetur MMPH-së.

Andaj, fokusimi i kësaj detyre është në direktivat e përmendura nën artikullin 2 dhe 3. Qasje speciale është iniciuar në mënyrë që të ketë rezultate kuptimplote shprehëse. Si hap i parë, Memorandumi i Mirëkuptimit është përgatitur për bashkëpunim të ngushtë në mes të MEM-it dhe KEK-ut. Kjo përfundimisht është nënshkruar në Dhjetor 2006. Grupi punues është caktuar (përfshirë KEK-un) në mënyrë që të fillojnë aktivitetet.

Si bazë e diskutimeve të grupit punues, konsulenti ka përgatitur një plan të implementimit dhe afat kohor për direktivat e IMD-së dhe të Sulfurit. Grupi punues duhet të adaptojë planin dhe afatin kohor sipas situatës aktuale dhe preferencës në Kosovë.

IMD-të synojnë në reduktimin e ndotësve të caktuar në ajër nga instalimet e mëdha djegëse (>50 MW). Në Kosovë, vetëm termocentralet e KEK-ut bien nën Direktivën e IMD-së, andaj është me rëndësi angazhimi dhe përfshirja e KEK-ut në aktivitetet e grupit punues.

Direktiva e Sulfurit synon në reduktimin e ndotësve në ajër si rezultat i përmbajtjes së sulfurit në karburantet e lëngëta. Kjo kryesisht ka të bëjë me

importimin e karburanteve pasi që Kosova nuk posedon karburante fosile të vetat (përveç linjitet).

Konkluzionet kryesore lidhur me implementimi e dy direktivave janë si në vijim:

- Implementimi i IMD-së është kryesisht i komplikuar. Jo vetëm kostot ekonomike kuptimplote janë përfshirë, por gjithashtu nga perspektiva e zbatimit të menaxhimit dhe implementimit është i vështirë.
- Pa një vlerësim të plotë të kostos ekonomike të implementimit të Direktivës së IMD (nën skenari të ndryshme) për KEK-un, zhvillimi i planit real implementues nuk është i mundshëm. Grupi Punues, përfshirë KEK-un duhet të iniciojë studim diagnostikim në mënyrë që ti përcaktojë nivelet aktuale të emetimit dhe kostot ekonomike të pajisjes për pakësimin e ndotësve të ndryshëm nën skenar të ndryshëm të zhvillimit.
- Prioriteti më i lartë është instalimi i pajisjes për monitorim të emetimit në KEK.
- Aktualisht, stafi i trajnuar në dispozicion është i pamjaftueshëm. Andaj, duhet një vëmendje e posaçme duhet ti kushtohet trajnimeve adekuate për stafin e ardhshëm të domosdoshëm të të gjitha organizatave relevante.

## 1 Hyrje

Një prej detyrave të caktuar në Termet e Referencës (TeR), të caktuar nga AER-Eptisa, është zhvillimi i një Plani për Implementimin e Acquis për Mjedis të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Evropës Jug-Lindore (Neni 12), në të cilën UNMIKU-Kosova është një nga vendet pjesëmarrëse. Veç kësaj, Traktati i Komunitetit të Energjisë të Evropës Jug-Lindore thekson në Nenin 13 dhe 14 që vendet pjesëmarrëse të Traktatit, do të përpiqen të miratojnë Kyoto Protokollin dhe implementojnë Direktivën e Këshillit 96/61/EC të datës 24 Shtator 1996 lidhur kontrollin dhe integrimin e preventivit të ndotjes’.

Shtojca/Aneksi II i Traktatit paraqet Afatin Kohor për Implementimin e elementeve të ndryshme të acquis mbi mjedis. Afati Kohor duket si në vijim:

Direktiva e BE-së	Koha
1. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë Direktivën e Këshillit 85/337/EEC të datës 27 Qershor 1985 për vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private për mjedis, siç është rregulluar nga Direktivat e Këshillit 97/11/EC të datës 3 Mars 1997 dhe Direktivës 2003/35/EC të Këshillit të Parlamentit Evropian të datës 26 Maj 2003.	Me hyrjen në fuqi të Traktatit
2. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë Direktivën e Këshillit 1999/32/EC të datës 26 Prill 1999, lidhur me reduktimin e përmbajtjes së Sulfurit në karburantet të caktuara të lëngshme dhe amendimin/korrigjimin e Direktivës 93/12/EEC.	Deri me 31 Dhjetor 2011
3. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë Direktivën 2001/80/EC të Këshillit të Parlamentit Evropian të datës 23 Tetor 2001 mbi limitimin e emetimeve të ndotësve të caktuar në ajër nga Impiantet e Mëdha Djegëse.	Deri me 31 Dhjetor 2017
4. Secila Palë Kontaktuese do të implementojë Nenin 4(2) të Direktivës e Këshillit 79/409/EEC të datës 2 Prill 1979 për mbrojtjen e zogjve të egra.	Me hyrjen në fuqi të Traktatit

Kapitujt e ardhshëm kanë të bëjnë me implementimin e secilës direktivë.

### Qasja

Kjo detyrë e projektit kërkon një qasje speciale të veçantë sepse përgjegjësia kryesore për zhvillimin e legjislacionit për mjedis bie me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH). Ky fakt e bën të nevojshëm koordinimin efektiv dhe kooperimin në mes të dy ministrive dhe organeve tjera relevante si dhe industrisë.

Në fillim të projektit, MEM-i dhe MMPH-ja nuk kanë pasur kontakt strukturor rreth çështjeve të energjisë dhe mjedisit. Kjo ka komplikuar implementimin e

detyrës për arsye se zhvillimi i planeve të implementimit në MEM në izolim nuk është efektive pa angazhimin e ministrive përgjegjëse.

Andaj, hapi i parë ishte propozimi për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të MEM-it dhe MMPH-së në mënyrë që të lejohet kontakti strukturor në mes të departamenteve të ndryshme të ministrive. Konsulenti ka përgatitur tekstin për Memorandumin e Mirëkuptimit (shiko Shtojcën/Aneksin II). Në muajin Tetor, është përgatitur një dokument i shkurtër për Sekretarin Permanent të MEM-it duke informuar atë rreth statusit të MM dhe kooperimit me MMPH. Pas një sërë takimesh për komente, MM finalist është nënshkruar nga ana e të dy Sekretarëve Permanent të dy ministrive në Dhjetor 2006.

Grupi punues i formuar aktualisht është duke e diskutuar implementimin e acquis për mjedis fokusuar në Direktivën e Impianteve të Mëdha Djegëse (IMD) dhe Direktivën e Sulfurit. KEK-u si e vetmja kompani që bie nën Direktivën e IMD-së është e përfshirë në diskutimet e grupit punues.

Hapi i dytë, është zhvillimi i propozimit për implementimin e dy direktivave si bazë për diskutimet e grupit punues. Konsulenti ka përgatitur një propozim për implementim e të dy Direktivave, të IMD-se dhe atë të Direktivës së Sulfurit. Grupi punues do ti adaptojë ato sipas zhvillimeve aktuale në Kosovë.

Kapitujt tjerë kanë të bëjnë me katër direktiva të theksuara në Traktat dhe statusin aktual të tyre.

## **2 Situata Aktuale e Legjislacionit të Mjedisit në Kosovë**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë sikurse shumica e organeve qeveritare është relativisht e re. Ka filluar procesin e krijimit të një kornize punuese ligjore për mbrojtjen e mjedisit në vitin 2003 me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (nr. 2002/8). Ligji definon parimet e përgjithshme, mekanizmat dhe mjetet që do të përdoren për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm. Po ashtu paraqet ligjet e kornizës punuese për Mbrojtjen e Ajrit (nr. 2004/30) dhe Ujit (nr. 2004/24).

Duke e ditur historinë e Kosovës dhe situatën aktuale ekonomike, MMPH synon të paraqesë mbrojtjen graduale të mjedisit duke shfrytëzuar normat dhe standardet bazuar në praktikën e BE-së dhe WHO. Ekziston një dispozitë për standardet dhe normat e përkohshme mbi pajisjet ekzistuese në mënyrë që të merret parasysh periodha aktuale në tranzicion.

Qeveria pas pranimit të një propozimi nga Ministria, ka autoritetin të lëshojë aktet normative suplementare që përcakton limitet e niveleve të pranueshme për Shkarkimin dhe Emetimin e ndotësve – përfshirë këtu ndotësit e ngurtë, të lëngët, gaztë – dhe substancat e rrezikshme në ajër, ujë, dhe tokë.

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtje të Mjedisit (nenet 20-23) Qeveria aprovoi Direktivën Administrative për Vlerësimin e Efektit në Mjedis (nr. 9/2004). Direktiva definon dhe specifikon procedurat për identifikim, vlerësim, raportim

dhe menaxhim të Efekteve të Projektit të Propozuar në Mjedis, të numëruara në Aneksat I dhe II, për tu siguruar se të gjitha informatat relevante për mjedisin merren parasysh në vendimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lëshimin e Miratimit dhe Lejes për Mjedis.

MMPH po ashtu planifikon të përpilojë Ligjin mbi Parandalimin dhe Kontrollimin e integruar të ndotjes (PKIN) bazuar në Direktivën e SH. E 96/61/EEC.

Praktika aktuale për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë mund të përmbledhet si në vijim:

- Megjithëse palët e korzoniës punuese të legjislativës së Mbrojtjes së Mjedisit janë paraqitur, kapaciteti institucional (stafi i trajnuar i autoriteteve kompetente; alokimet e buxhetit) për zbatim nuk është i mjaftueshëm.
- Shumica e paisjeve operojnë pa lejet e nevojshme (përkohshme) mjedisore.
- Në saje të situatës ekonomike, kompanitë e prekura nga ligjet e mjedisit kanë mungesë të kapacitetit teknik dhe menagjerial për pajtueshmëri të plotë si dhe për financat e nevojshme.
- Kosovës i mungon një sistem monitories i operimeve mjedisore dhe kjo e vështirëson krijimin e politikave të plota mjedidore dhe sistemet zbatuese.

### **3 Direktiva e Këshillit 1999/32/EC të datës 26 Prill 1999 (Direktiva e Sulfurit)**

#### **3.1 Gjeneral**

BE-ja ka përpiluar një elaborat të kornizës së punës për legjislacionin e kualitetit të ajrit. Pikësynimi:

- a. Krijimin dhe mirëmbajtjen e kualitetit të ajrit, si dhe vendosjen e limiteve në nivele të ndotësve të specifikuar në ajër së bashku me kërkesat për monitorimin dhe raportimin mbi nivelet e ndotjes;
- b. Kontrollimin e emetimeve nga llojet e caktuara të burimeve, duke rregulluar depot dhe transportimin e naftës, si dhe përmbajtjen e sulfurit në karburante; dhe
- c. Ratifikimin dhe implementimin e konventave ndërkombëtare relevante dhe protokolleve, në të cilën Komuniteti dhe vendet anëtare të tyre janë pjesëmarrëse.

Thelbi i legjislacionit për kualitet të ajrit përmban gjashtëmbëdhjetë Direktiva të Këshillit dhe dhjetë Vendime të Këshillit. Këto instrumente janë të dobishme kur grupohen në:



- a. kontrollin e produktit dhe menaxhimin e materialit,
- b. standardet e kualitetit të ajrit në ambient (vlerat e limitit dhe direktivat),
- c. vlerësimin e kualitetit të ajrit në ambient dhe menaxhimi;
- d. monitorimin dhe shkëmbimin e informacionit.

Direktiva e Këshillit 1999/32/EC të datës 26 Prill 1999 lidhur me reduktimin të përmbajtjes së sulfurit në karburante të caktuara të lëngëta dhe amandamentimin/korrigjimin e Direktivës 93/12/EC, klasifikohet nën llojin e kategorisë (a) të direktivës, posaçërisht për sa i përket ndotjes SO<sub>2</sub>.

Direktiva përcakton limitin maksimal të përmbajtjes së sulfurit në benzine, gjithashtu të njohura si karburante të lehta të naftës për djegieje, ndërmjet të tjerash të cilat përdoren për ngrohje, për marine dhe për nevoja industriale. Direktiva nuk përfshinë karburantet me qellim të procedimit; karburantet me përjashtim të gazit detar dhe diselit i cili përdoret për anije detare; gazi detar dhe diseli i cili përdoret nga anijet të cilat kalojnë kufirin ndërmjet një shteti të tretë dhe shtetit anëtarë; ose për karburantet e aviacionit. Direktiva lejon zhvleftësim nga kërkesat lidhur me përmbajtjen e sulfurit të karburanteve, nëse standardet e kualitetit të ajrit për dioksidin e sulfurit të shtruar në legjislacionin tjetër të BE-së respektohen, dhe emetimet e tilla nuk kontribuojnë në tejkalimin e pikës kritike në asnjë nga shtetet anëtare.

### 3.2 Obligimet bazë

Obligimet kryesore për Kosovën që do të barten në ligjin kombëtar janë si në vijim:

#### Rregulloret

- Me përfundimin e fazës tranzitore, (e cila do të caktohet për Kosovën), të ndalohet përdorimi i karburanteve të rënda të naftës (mazut) nëse përmbajtja e sulfurit në të kalon 1.00% në masë (Neni. 3 të Direktivës 99/32/EC).
- Të sigurohet që impiantet djegëse që përdorin karburante të rënda të naftës (mazut) me koncentrim më të madh se 1.00% të sulfurit, operon me leje e cila specifikon limitet e emetimit (Neni. 3 të Direktivës 99/32/EC).
- Me përfundimin e fazës tranzitore, të ndalohet përdorimi i benzinës, përfshirë dhe diselën, nëse përmbajtja e sulfurit në të tejkalon 0.2 % në masë (Neni. 4 të Direktivës 99/32/EC).
- Me përfundimin e fazës tranzitore të ndalohet përdorimi i benzinës, përfshirë dhe diselën, nëse përmbajtja e sulfurit tejkalon 0.10 % në masë (Neni. 4 të Direktivës 99/32/EC).
- Të konsiderohet, nëse është e aplikueshme për Kosovën, lejimi i përdorimit të karburanteve të rënda të naftës (mazutit) me përmbajtje të sulfurit në mes 1.00% dhe 3.00% në masë, nëse emetimet nuk shkaktojnë tejkalimin e niveleve kritike kombëtare dhe nëse standardet e kualitetit të ajrit, të precizuara në Direktivën 80/779/EEC

respektohen nga të gjitha legjislacionet tjera që shfuqizojnë dhe zëvendësojnë këto standarde (Nenet 3(2) dhe 3(5) të Direktivës 99/32/EC).

- Të aplikohen gjobitje të zbatueshme për mosrespektimin e dispozitave kombëtare, të paraparë me Direktivë. Gjobat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe ndëshkuese-korrektuese. (Neni 11 të Direktivës 99/32/EC).

### Monitorimi

- Të verifikohet me anë të metodës së mostrave, që benzina me përmbajtje të sulfurit të përdorur në territor është në pajtueshmëri me kërkesat e Direktivës. Testimi duhet të fillojë brenda gjashtë muajve në datën kur limiti relevant për maksimumin e përmbajtjes së sulfurit hynë në fuqi, dhe duhet të zbatohet me frekuencë të mjaftueshme që të sigurohet se mostrat janë përfaqësime të karburantit të ekzaminuar (Neni 6 të Direktivës 99/32/EC).
- Të përdoren metodat referuese në vijim për përcaktimin e përmbajtjes së sulfurit:
  - ISO metoda 8754 (1992) dhe PrEN ISO 14596 për karburantet e rënda të naftës (mazuti) dhe benzinës;
  - EN metoda 24260 (1987), ISO 8754 (1992) dhe PrEN ISO 14596 për benzinë. (Neni 6 të Direktivës 99/32/EC);
  - Të përdoret metoda PrEN ISO 14596 (Neni 6 të Direktivës 99/32/EC);
  - Të sigurohet që interpretimi i statistikave për verifikim të përmbajtjes së sulfurit në benzinë është zbatuar në përputhje me standardin ISO 4259 (1992) (Neni 6 të Direktivës 99/32/EC).

Një numër tjetër i instrumenteve legjislative kanë lidhje me kontrollimin e emetimeve atmosferike nga resurset lëvizëse, dhe duhet të konceptohen në mendje gjatë implementimit të kësaj direktive. Këtu përfshihet Direktiva Ligjore e Kualitetit të Ajrit (96/62/EC) dhe Direktivat e Standardeve të Kualitetit të Ajrit (në substancat e caktuara, motorë, dhe impiante djegëse).

### Raportimi

Ekziston kërkesa për raportim që parashihet në direktivë lidhur me heqjet/limitet nga direktiva apo të çfarëdo problemi që paraqitet gjatë implementimit të limiteve të sulfurit. Procedura dhe përmbajtja për raporte duhet të zhvillohen për dorëzim në qeveri, dhe partnerëve të Traktatit.

### 3.3 Implementimi i Direktivës në Kosovë

Ky dokument siguron disa udhëzime të procesit të implementimit shoqëruar me një skicë të detyrave të ndryshme që nevojiten të zbatohen për

implementimin e direktivës. Dokumenti tregon edhe një afat kohor indikativ për detyrat e veçanta.

#### *Vërejtjet gjeneral të implementimit*

Implementimi praktik i dispozitave të direktivës do të varet nga nevojat e posaçme, strukturave administrative dhe institucionale, dhe resurseve të secilit vend. Sidoqoftë, këtu jepen shkurtimisht disa sugjerime për implementimin e direktivës, marrë nga përvoja e shumë vendeve anëtare.

Rregullat Kombëtare që ndërsjellin këtë direktivë në shumicën e vendeve anëtare janë pjesë e rregullave në kushte specifike për karburantet e motorit.

Ministria me përgjegjësi kryesore për administrimin e legjislacionit kombëtarë e cila ndërsjellë kërkesat për përmbajtjen e sulfurit në karburantin e rëndë të naftës (mazuti i lehtë/solar) dhe benzinës mund të jetë ministria përgjegjëse për çështje të energjisë ose ministria përgjegjëse për çështje mjedisore. Sidoqoftë, pasi që qëllimi i direktivës është kontrolli i kualitetit të ajrit, cilado ministri që ka përgjegjësi primare duhet të koeprojë ngushtë me ministrinë përgjegjëse për çështje të mjedisit, dhe me ministrinë tjera siç është Ministria e Transportit, në zhvillimin e legjislacionit për ndërsjellën e kërkesave të direktivës, dhe në vendosjen e masave për implementimin e kërkesave të direktivës. Gjithashtu, autoritetet duhen të mbajnë takime dhe diskutime me përfaqësuesit e sektorit të naftës dhe me pjesëmarrës tjerë relevant në mënyrë që të mënjanohen problemet dhe pakënaqësitë.

Përvoja brenda vendeve të BE-së sugjeron se, detyra e cila merr shumë kohë dhe kërkon përkushtim, shoqëruar me implementimin e kësaj direktive, është vendosja e një sistemi efektiv për monitorim të përmbajtjes së sulfurit në karburante të rënda të naftës (mazuti i lehtë/solar) dhe benzinës që përdoret në territorin e tyre. Planifikimi dhe vendosja e sistemeve të monitorimit dhe procedurat duhet të fillojnë gjatë fazës fillestare të implementimit.

Heqje/kufizime/ulje te kërkesave ne direktivë janë të mundshme. Për shembull, Polonia ishte e autorizuar për një periudhë të caktuar që të përdorë karburante të rënda të naftës (mazuti i lehtë/solar) me përmbajtje të sulfurit më të lartë se 1% në një nga impiantet djegëse të saj. Një shembull tjetër te ngjashëm kemi me Shtetet Anëtare (A) qe iu kane bashkuar Unionit Evropian me 1 Janar 1995. Ne këtë, Akti i Shteteve Anëtare ka autorizuar te mbaje limitin 0.1% te sulfurit ne benzine, krahasuar me Komunitetin ku limiti është 0.2%.

Direktiva kërkon që përmbajtja e sulfurit të benzinës që përdoret në territor të Komunitet të verifikohet me anë të metodës së mostrave. Organizata e caktuar për regjimin e vëzhgimit të mostrave është lënë në maturi të vendit, por sistemi duhet të jetë efikas dhe të sigurojë që kualitetit i benzinës i plasuar në treg përmbushë kërkesat e paraqitura në direktivë. Testimi i mostrave duhet të zbatohet me frekuencë të mjaftueshme dhe në atë mënyrë që mostrat të jenë përfaqësim i benzinës së ekzaminuar.

Autoritetet/organizatat të vendosura për zbatimin e funksioneve të monitorimit duhet të kenë organ administrativ (resurse të mjaftueshme njerëzore, teknike

dhe financiare), përfshirë testimin e mostrave dhe metodologjinë e interpretimit të të dhënave statistikore, dhe për testimin e niveleve të përmbajtjes së sulfurit dhe fuqizimin e kërkesave.

Autoritetet lokale mund të bëhen përgjegjëse për monitorim brenda juridiksionit të tyre. Gjithashtu mund të kërkohet nga aktorët e sektorit privat të monitorojnë furnizimet e tyre të benzinës dhe ti raportojnë rezultatet në autoritetet relevante.

Karburantet e importuara në shumicën vendeve monitorohen nga Departamenti Doganor dhe Akcizës, duke përdorur laboratorët e tyre për testimin e mostrave, ku ato janë në dispozicion.

Kualiteti i karburantit duhet të verifikohet në platformën e stacionit të gazit. Kjo mund të bëhet nga zyrtarët e autoritetit lokal, p sh nga inspektorët e mjedisit dhe/apo inspektorët e shëndetësisë.

### **Kostot**

Llojet kryesore të kostove që rrjedhin gjatë implementimit të Direktivës së Impianteve të Mëdha Djegëse janë si në vijim:

*1. Organizimi fillestar i kostove:*

- Themelimi i autoritetit kompetent;
- Ndarja e sistemeve dhe procedurat;
- Sigurimi i trajnimit;
- Përgatitjet e shënimeve udhëzuese teknike.

*2. Harxhimet kryesore:*

- Analizuesi i sulfurit në karburant (përafërsisht 50,000 Euro)

*3. Kostot rrjedhëse në vazhdim:*

- Pajisjet për testimin e mostrave (veglat)(përafërsisht 150-200 Euro për secilin);
- Kostot e punës apo fuqisë punëtore për aktivitetin e metodës së testimi;
- Kostot e punës në analizimin e karburanteve;
- Kostot për operimin e analizimit të karburanteve;
- Kostot për procedimin e të dhënave dhe raportimi

### 3.4 Detyrat kryesore për implementim

I	Planifikimi dhe Vlerësimi	Institucioni Përgjegjës
1	<p>Autoritetet përkatëse dhe organizatat tjera përgjegjëse për përcaktimin e kualitetit të karburanteve të rënda të naftës (mazutit), benzinës dhe diselit të cilët përdoren në territorin e tyre përfshijnë përgjegjësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjedhjen e mostrave dhe analizimin e kualitetit të karburanteve të rënda të naftës (mazuti) i cili përdoret në impiante ose gjetiu, dhe benzinës për ngrohje apo për qëllime tjera,</li> <li>• Ndëshkimin e cilësdo thyerje të dispozitave kombëtare të paraparë me direktivë.</li> </ul>	MTI
2	Zbatimi i vlerësimit të përmbajtjes së sulfurit në karburante të rënda të naftës (mazuti) në impiante dhe të benzinës të përdorur në territorin e tyre.	MTI, (përgjegjes), MMPH, MEM,KEK (pjesemarres)
II	Rregulla	
1	<p>Të krijohet sistemi rregullativ me qëllim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• sigurimit se karburantet e rënda të naftës (mazuti) me përmbajtjet të sulfurit më të madh se 1% nuk janë përdorur që nga fund i periudhës tranzitore [që të definohet për Kosovën];</li> <li>• sigurimit se benzina më përmbajtje të sulfurit më të madhe se 0.20% nuk është përdorur që nga fundi i periudhës tranzitore [që të definohet për Kosovën];</li> <li>• mbulimit të situatave të jashtëzakonshme, atëherë kur mund të jetë vështirë të zbatohen limitet relevante të përmbajtjes maksimale të sulfurit në karburantet e lëngshme. Në këtë rast do të duhej përcaktuar limite më të larta të përmbajtjes së sulfurit të lejuar, limite kohore për këtë lloj zhvleftësimi, dhe një sistem për paralajmërim (njoftim) të këtyre zhvleftësimeve.</li> </ul>	MTI
2	Draft teksti ligjor dhe apo/amandamentet	MTI
III	Monitorimi	
1	Të krijohet sistemi dhe procedura për monitorimin e përmbajtjes së sulfurit në karburante të rënda të naftës (mazutit) dhe benzinës, të cilat do të përdoren në	MTI

	territorin e tyre. Kjo përfshinë dizajnimin dhe kontrollin e karburanteve të sektorit publik/privat për realizimin e analizave të mostrave të marra.	
2	Të sigurohet trajnim relevant në monitorim të procedurave, në veçanti në metodën ISO 8754 për përcaktimin e përmbajtjes së sulfurit në benzinë; dhe në ISO standardet 4259 për interpretimin e rezultateve të kontrollit të përmbajtjes së sulfurit në benzinë.	MTI, MMPH
<b>IV</b>	<b>Raportimi</b>	
1	Të krijohet sistemi (për shembull databaza) për mbledhjen e rezultateve nga mostrat dhe analizat e karburantit të rëndë të naftës (mazuti i lehtë/solar) dhe benzinës të përdorur në impiante, dhe metoda për nxjerrjen e raportit vjetorë.	MTI
2	Të raportohet para Komisionit/Partnerëve të Traktatit për çdo vit për përmbajtjen e sulfurit në karburantet të lëngshme të cilat përfshihen në kategorinë e përcaktuar të kësaj direktive dhe të përdorur brenda shtetit anëtarë gjatë vitit paraprak kalendarik. Ky raport do të përfshijë përmbledhjen e zhvleftësimeve të lejuara në vijim të Nenit 3(3), dhe çfarëdo vështërsive në aplikimin specifikave të karburanteve në rast të vështërsive në furnizim.	MTI
<b>V</b>	<b>Këshill Teknike dhe Udhëzim</b>	
1	Të përgatitet dhe të aplikohet direktiva për monitorimin e procedurave të cilat inkorporojnë ISO metodën 8754, dhe ISO standardet 4259	MTI

### **3.5 Afati Kohor Indikativ**

Skica dhe diagrami në faqen vijuese tregon një afat kohor indikativ për implementimin e direktivës së Sulfurit në Kosovë. Duhet të mirën parasysh që aty të parashikohet se nuk ka pengesa financiare që e ndalon implementimin e afatit kohor.

**Afat kohor indikativ për implementimin e direktivës së Sulfurit në Kosovë**

ID	Task Name	2007				2008				2009				2010				
		Qtr 3	Qtr 4	Qtr 1	Qtr 2	Qtr 3	Qtr 4	Qtr 1	Qtr 2	Qtr 3	Qtr 4	Qtr 1	Qtr 2	Qtr 3	Qtr 4	Qtr 1	Qtr 2	Qtr 3
1	<b>Planning and Assessment</b>																	
2	Designate authorities and other organisations with responsibility for regulating the quality of heavy fuel oil and gas oils, including marine gas and diesel oils, used in their territory																	
3	Carry out assessment of sulphur content of heavy fuel oil in plants and of gas oils used in their territory																	
4	<b>Regulation</b>																	
5	Establish a regulatory system																	
6	Draft legal texts and/or amendments																	
7	<b>Monitoring</b>																	
8	Set up a system and procedure for monitoring the sulphur content of heavy fuel oil and gas oils, including marine gas and diesel oils, used in their territory.																	
9	Provide relevant training on monitoring procedures, in particular in ISO method 8754 for determining the sulphur content of gas oils; and on ISO standards 4259 for interpreting results of checks on sulphur content of gas oil.																	
10	<b>Reporting</b>																	
11	Set up a system (for example a database) to collect results of sampling and analysis of heavy fuel oil used in plants and gas oils.																	
12	Report to the Government each year on the sulphur content of the liquid fuels falling within the scope of this Directive and used within																	
13	<b>Technical Advice and Guidance</b>																	
14	Prepare and issue guidance on monitoring procedures which incorporate ISO method 8754 and ISO standards 4259																	


## 4 Direktiva e Këshillit 2001/80/EC të datës 23 Tetor 2001 (Direktiva e IMD-së)

### 4.1 Gjeneral

Direktiva e IMD formon një pjesë të legjislatives së BE-së mbi kontrollimin e ndotjes industriale dhe merret me vlerat limituese për substancat specifike (SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub> dhe grimcat). Direktivat tjera që ballafaqohen me kontrollimin e ndotjes industriale janë Direktivat e Emetimeve Tavan Vendore, Direktiva Seveso II, Menaxhimi Eco i Komunitetit dhe rregullorja Skema Audit (MESA) dhe Skema Eco e Komunitetit për vendosjen e etiketave. Direktiva IPPC prezantoi një ndryshim të madh në sistemin e lejeve për instalimet e caktuara. Direktiva kërkon një integrim të plotë të kontrollimit të burimit të ndotjes në sistemin lejues.

Megjithëse Direktiva IPPC nuk cakton vlera limituese të emetimeve për shtetet e BE-së, ajo shfrytëzon ELV të siguruar nga direktivat tjera specifike për sektorët (uji, hedhurinat etj) si nevojë minimale. Aty ku është e nevojshme IPPC mund të caktojë limitet strikte bazuar në Teknikat më të mira në dispozicion.

Hierarkia ndërmjet IPPC dhe legjislatives tjetër specifike të sektorit dhe limitet e tyre të emetimeve paraqiten në skicën e mëposhtme me një shembull të direktivave të ndotjes së ajrit.



Pjesa vijuese flet për çështjet kyçe të direktivës së IMD-se.

### 4.2 Obligimet e IMD-së

Direktiva e Impianteve të Mëdha Djegëse (2001/80/EEC që ka rrjedhur nga rishikimi 88/609/EEC e rregulluar me Direktivën 94/66/SH. E) cakton një numër kontrollimesh në lidhje me operimin e impianteve të mëdha djegëse me një me hyrje nominale termike prej 50 MW apo më shumë, pavarësisht nga lloji i karburantit të përdorur.



Elementet kyçe të Direktivës janë obligimet për zhvillimin e programeve për reduktimin e emetimeve nga impiantet ekzistuese (Neni3) bazuar në emetimet tavan dhe përqindjen korenduese të reduktimeve ashtu si ceket në Aneksin I dhe Aneksin II të Direktivës në mënyrë që të ndalohen shkaktarët kryesor të shiut acid duke limituar apo reduktuar emetimet e dyoksid sulfurit (SO<sub>2</sub>) dhe oksideve të azotit (NO<sub>x</sub>), si dhe kufizimin e emetimeve të pluhurit, veçanërisht nga impiantet e reja, pa paragjykuar Direktivën IPPC dhe duke pasur në mendje obligimet nga Direktiva e Emetimeve vendore Tavan (EVT). Impiantet ekzistuese janë subjekt i emetimeve tavan vendore me reduktime fazore dhe me limite të ndryshme për shtete të ndryshme.

Direktiva i ndan IMD të hyjnë në një rën nga këto klasë varësisht se kur janë licencuar për herë të parë.

- Impiant “Ekzistues” (ato që janë licencuar për herë të para 1 Korrikut 1987);
- Impiant “i ri” (ato që janë licencuar për herë të parë ndërmjet 1 Korrikut 1987- 27 Nëntorit 2002); dhe
- Impiant “Shumë i ri” (ato që janë licencuar për herë të parë pas 27 Nëntorit 2002).

Turbinat e gazit të licencuara para 27 Nëntorit 2002 janë përjashtuar nga qëllimi i Direktivës. Megjithatë ato të licencuara pas kësaj date si njësit i vetëm apo së bashku me ndonjë IMD në të njëjtën vendndodhje dhe ku hyrjet nominale termike janë 50 MW apo më shumë, janë të përfshira.

Direktiva e rishikuar e IMD merr parasysh përparimet e vonshme në djegie dhe teknologji dhe paraqet limite të rishikuara për lirimimin e SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe pluhurit për IMD që duhet të arrihen në data të caktuara sipas kategorisë së IMD apo për turbinat e gazit.

Shtetet është dashur të përpilojnë programet për reduktimin progresiv të emetimeve totale vjetore të SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> impiantet ekzistuese në përputhje me ato tavan. Limitet e emetimeve të aplikueshme në autorizime individuale në impiantet e reja janë definuar dhe janë subjekt i regjimit licencues (Neni. 4) në vijë me kërkesat e pjesës A apo B të Anekseve III deri në VII. Limitet e emetimeve duhet të përcaktohen për SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, dhe pluhur.

Shtetet po ashtu duhet të krijojnë një mekanizëm për adoptimin e emetimeve vendore tavan dhe të kalojnë përgjegjësinë në një apo më shumë autoritete kompetente për krijimin e planeve në arritjen e emetimeve tavan. Në pikëpamjen e zhvillimeve të vazhdueshme, rekomandohet që ky mekanizëm të jetë mjaft fleksibil për të lejuar llojet e ndryshme të tavanëve dhe ndotësve të mbulohen. Kjo mund të arrihet duke bërë një kusht për adoptimin e rregulloreve që saktësojnë tavanet dhe definojnë se si mund të arrihen këto tavanë.

Për Kosovën implikimi i Direktivës së IMD ka të bëjë vetëm me sektorin e gjenerimit të energjisë elektrike, në veçanti Impiantet Kosova A dhe B që i përkasin Kompanisë së Energjisë Elektrike të Kosovës (KEK).

Obligimet kryesore për Kosovën në lidhje me paraqitjen e Direktivës së IMD janë:

### **Planifikimi**

- zhvillimi dhe implementimi i programit(eve) për reduktimin e emetimeve të sulfur dioksidit (SO<sub>2</sub>) dhe oksid azotit (NO<sub>x</sub>), dhe pluhurit të impianteve ekzistuese (Nen. 3 dhe Aneksi IX) dhe raportimi i këtyre planeve.

### **Rregullimi**

- sigurimi se licencat për impiantet e reja përmbajnë kushtet në lidhje me përputhshmërinë me vlerat limituese të emetimeve (Neni. 4 dhe Aneksat III deri në VII);
- heqja e impianteve më të mëdha se 400 MW që nuk operojnë për më shumë se 2000 orë për vit deri në Dhjetor 2015 dhe 1500 orë në vit nga 1 Janari 2016 (Neni. 5) (heqja e 2000 orëve aplikohet në impiante jo në një kazan individual – obligimet e Direktivës aplikohen në impiante e jo në kazanët e zgjedhur të impiantit);
- interesimi mbi përdorimin e ngrohjes së kombinuar me energjinë (Neni. 6);
- procedurat të përcillen në rast të mos funksionimit apo prishjes së pajisjeve (Neni. 7);
- një kalkulim i vlerave limituese të emetimeve kur ka djegie të karburanteve të shumëfishta (Neni. 8);
- shkarkimi i gazrave plehra nëpërmjet një gypi (Neni. 9);
- shtrirja e kapacitetit për më shumë se 50 MW do kërkojë limite të reja të emetimeve të impiantit (Neni. 10);

### **Monitorimi dhe Zbatimi**

- Shfrytëzimi i monitorimit apo vetë-monitorimi i emetimeve dhe një kërkesë për raportim të emetimeve (Neni. 12, 13 dhe 14);
- Përcaktimi i emetimeve vjetore të dioksid sulfurit, dhe oksideve të azotit nga impiantet (Neni. 12 dhe Aneksi VIII (A));
- Monitorimi i emetimeve nga impiantet në përputhje me metodat e specifikuar, duke u siguruar se operatorët raportojnë rezultatet e monitorimit në autoritetet kompetente, dhe vlerësojnë rezultatet e

monitorimit në pajtim me kriteret e specifikuara (Nenet. 13, 14 dhe 15, dhe Aneksi IX);

- Përdorimi i dënimeve efektive, proporcionale dhe zbindëse (Neni 16); dhe
- Kur vlerat e limiteve tejkalohen duhet të sigurohemi se ndërmerret veprimi për të arritur pajtueshmëri sa më shpejt që është e mundur, dhe kur ka prishje të pajisjeve, të sigurohemi se ndërmerret veprimi që redukton pasojat e prishjes përdërisa impianti të mundet të operojë normalisht përsëri (Neni. 7).

## Raportimi

- Konsultimi me Palët tjera SEE-ECT, ku ndërtimi i një impianti ka gjasa të ketë efekte të mëdha në mjedisin e Shtetit tjetër Anëtar (Neni. 11).
- Raportimi para Palëve SEE-ECT mbi rezultatet e programeve implementuese (Neni15) duhet dhënë një vështrim të përgjithshëm mbi:
  - të gjitha impiantet djegëse të mbuluara nga Direktiva;
  - emetimet e dioksid sulfurit dhe oksid azotit në tone për vit dhe përqendrimit e gazrave ndotëse
  - masat e ndërmarra apo përballimi me pikëpamjen e reduktimit të emetimeve dhe në ndryshimet e zgjedhjes së derivatit të përdorur;
  - ndryshimet në metodën e operimit;
  - përfundimet definitive apo përballje; dhe
  - vlerat limituese të emetimeve të imponuara

### 4.3 Implementimi i Direktivës së IMD-së në Kosovë

Ky paragraf fillon me vërejtje të përgjithshme të implementimit të direktivave të BE-së në atë të legjislacionit kombëtarë dhe si të menaxhohet ky proces. Paragrafi tjetër i ven në pah detyrat tjerat të cilat duhet të zbatohen për implementimin e Impianteve të Mëdha Djegëse. Paragrafi final tregon orarin kohor për secilën detyrë.

#### *Vërejtjet gjeneral në implementim*

Implementimi i Direktivës së BE-së është një detyrë madhore, që kërkon një menaxhim dhe planifikim të kujdesshëm. Kosova duhet të ketë të vendosur kornizën e punës për koordinim legjislativ dhe praktikën administrative përgjatë ministrive të ndryshme, me pikëpamje të arritjes së implementimit të tërë në ligj dhe në praktikë. Gjithashtu, është e domosdoshme të rishikohen fushat e legjislacionit kombëtarë që mund të jenë të dëmtuar nga

implementimi i direktivës dhe çfarë amendamente mund të nevojiten në legjislacionin kombëtar.

Zakonisht, procesi i implementimit përfshinë tri faza: 1) Zhvendosjen (të legjislacionit), 2) implementimin, dhe 3) fuqizimin. Sidoqoftë, në fakt këto varen shume nga njëra tjetra. Së pari kërkohet zhvendosje efektive, kuptim tërësor i implementimit dhe praktikat e fuqizimit dhe aftësitë. Hartimi i tekstit legal aktual atëherë do të ishte relativisht lehtë.

Meqenëse administrata e vendit në të cilën implementimi dhe fuqizimi mbështetet, është me rëndësi që të rishikohen dhe përforcohen strukturat administrative për menaxhim të mjedisit. Kjo mund të përfshijë:

- Krijimin e ri apo ristrukturimin substancial të institucioneve ekzistuese;
- Përmirësimin e koordinimit dhe komunikimit ndër-ministror;
- Zhvillimin e institucioneve lokale dhe regjionale;
- Sigurimin e infrastrukturës teknike dhe trajnimin e mjaftueshëm të stafit;
- Ndërtimin e partneritetit me autoritetet komunale, ndërmarrjet e bizneseve dhe OJQ-të;

Menaxhimi i procesit të implementimit përfshinë disa hapa kritikë dhe vendimtarë para se të përpilohet programi efektiv implementues dhe orari kohor. Ato janë të paraqitura si më poshtë.

- Të përcaktohen përgjegjësit dhe kompetencat, si dhe linjat e komunikimit në mes të ministrive të ndryshme dhe organeve qeveritare të përshtirë në implementimit e direktivës
- Të përgatitet një studim diagnostik i situatës aktuale
  - Të kuptohen çështjet teknike të përfshira dhe përgatit listën për çështjet kyçe dhe pjesëmarrësit kyç;
  - Të bëhet një inventarë për pajisje që bien nën direktivë;
  - Të krijohet një nivel momental i pajtueshmërisë (pëlqim) për pajisje;
  - Të iu ipet prioritet çështjeve që do të adresohen;
  - Të vlerësohet sfera e përpjekjeve që kërkohet për pajtueshmëri (pëlqim)
- **Implikimet financiare**
  - Pajtueshmëri me metodologjinë për kalkulimin e kostos së pajtueshmërisë;

- Llogaritja e kostos për pajtueshmëri (pëlqim);
- Llogaritja e burimeve ekzistuese të fondeve dhe atyre deficitar;
- **Kapacitetet Institucionale**
  - Të sqarohen aranzhimet aktuale institucionale dhe përgjegjësitë;
  - Të përcaktohen resurset e stafit aktual dhe të llogariten kërkesat në të ardhmen;
  - Të propozohen ndryshime për reforma institucionale nëse është e nevojshme
  - Të llogariten kostot për reformë;
- **Konsultimi me Ministrinë e Financave**
  - Të krahasohen fondet ekzistuese dhe fondet e nevojshme për sektorin
  - Të identifikohen burimet potenciale të rrjedhës së fondeve;
  - Të iu epet prioritet masave për mbledhjen e fondeve;

### **Kostot**

Llojet kryesore të kostove që rrjedhin gjatë implementimit të Direktivës së Impianteve të Mëdha Djegëse janë si në vijim:

#### *1. Organizimi fillestar i kostove:*

- Themelimi i autoritetit kompetent;
- Ndarja e sistemeve dhe procedura;
- Sigurimi i trajnimit;
- Përgatitjet e shënimeve udhëzuese teknike.

#### *2. Harxhimet kryesore:*

- Modifikimi apo ndryshimi i impianteve ekzistuese për të plotësuar vlerat e limituara të emetimit;
- Ndërtimi i impiantit të ri për plotësimin e BAT për ndotjen e ajrit.

#### *3. Kostot rrjedhëse në vazhdim:*

- Procedimi i aplikacioneve të licencës;
- Funkionimi i teknologjisë për uljen e emetimit;

- Mirëmbajtja e inventarit të emetimit;
- Raportimi

Kostot kuptimplote do të ngjallen nga autoriteti kompetent në administrimin e direktivës, përfshirë licencimin, monitorimin, dhe raportimin. Sidoqoftë, rritja e kostove nga operatorët në përputhje me direktivën dhe uljen e emetimeve do të jetë shumë here më e lartë.

Në praktikë, shumica e kostove që bie në autoritetin kompetent gjithashtu do të kërkohet në mënyrë që të përputhet me Direktivën e IPPC (96/61/EEC). Aranzhimet duhet të bëhen për ti mbuluar së paku ca kosto nga operatorët përmes tarifës së licencimit në përputhje me parimin „ ndotësi paguan”

#### **4.4 Detyrat Kryesore për Implementim**

Çështjet kryesore për implementim janë:

- Sigurimi që plani i reduktimit në nivel kombëtarë të paraqitet deri në datat e caktuara më parë;
- Sigurimi që impiantet ekzistuese të jenë të modifikuara, në mënyrë që të përmbushin shkallën e emetimit të përcaktuar; dhe
- Sigurimi që impiantet e reja të jenë në përputhshmëri me kufizimet e specifikuar të emetimit.

Teksti në vazhdim paraqet një numër të observimeve në përgjithësi dhe sugjerimeve për implementimin e kësaj direktive duke u bazuar në përvojën e përbashkët të shteteve anëtare të BE-së.

#### **Planifikimi**

- Autoriteti kompetent duhet siguruar që impiantet industriale të përfshira në këtë direktivë të jenë të autorizuar në mënyrë të duhur, pastaj që caqet për reduktim të emetimit të jenë të përcaktuar për secilin impiant veç e veç, që impiantet të përmbushin standardet dhe që të bëhet raportimi i kërkuar në lidhje me këtë. Në shumicën e vendeve, autoriteti më kompetent për realizimin e këtyre detyrave do të ishte agjencia për mbrojtjen e mjedisit.
- Alokimi i caqeve për reduktimin e emetimit në impiantet djegëse, në shkallë të ndryshme, do të kërkojë marrjen e vendimeve në politikën energjetike, të cilat vendime mund të kenë pasoja të natyrës sociale dhe asaj ekonomike. Për këtë arsye qeveria qendrore dhe ministritë të cilat merren me çështjet e mjedisit dhe ato të energjisë duhet të kenë parasysh këto pasoja.

## Rregulla, Monitorimi dhe Fuqizimi

- Në secilin rast, autoriteti kompetent duhet të informohet dhe të pajtohet në rast të propozimit të mos përmbajtjes nga limitet e përcaktuara të emetimit. Për këtë qëllim operatori i cili drejton impiantin, duhet ta ketë parasysh këtë, dhe të obligohet që në rast të paraqitjes së nevojës për ndryshim të shkallës së emetimit, atëherë autoriteti kompetent duhet të përcaktojë personin i cili do të shqyrtojë një kërkesë të tillë. Gjithashtu duhet përpiluar rregullat e operimit në mënyrë që këtë këto rregulla të jenë si udhërrëfyes për autoritetin kompetent në ato raste kur impianteve iu lejohet operimi si rezultat i nevojës shtesë për energji elektrike.
- Autoriteti kompetent duhet ti përcaktojë procedurat e monitorimit, përfshirë këtu edhe qasjet teknike, teknikat analitike, si dhe procedurat për dhënie të autorizimit. Artikulli 15 i Direktivës përcakton disa elemente të protokollit të monitorimit të cilat duhet të përfshihen në këtë procedurë. Rekomandohet që monitorimi të kryhet nga vetë operatorët por edhe nën mbikëqyrje nga autoriteti kompetent. Njëherit duhet bërë aranzhimet në mënyrë që rezultatet e fituara ti raportohen autoriteteve kompetent në mënyrë të qartë dhe të analizuar mirë. Rezultatet e monitorimit duhet të përfshihen brenda regjistrit publik.

Detyrat kryesore në vijim që kanë të bëjnë me implementimin e direktivave për Impiante të Mëdha Djegëse (IMD) janë këto:

<b>I</b>	<b>Përgatitja dhe Menaxhmenti</b>	<b>Institucioni Përgjegjës</b>
1	Të definohen përgjegjësitë dhe kompetencat, si dhe linjat e komunikimit ndërmjet mistrive të ndryshme dhe organeve qeveritare të përfshira në implementimin e direktivës.	MMPH, MEM, KEK
2	Të përgatitet një studim diagnostik për situatën aktuale	KEK
3	Të krijohet sistemi monitorues për kualitetin e ajrit në Kosovë	MMPH
4	Të përcaktohen implikimet financiare	MMPH, MEM, MEF
5	Të analizohen kapacitetet institucionale	MMPH
6	Konsultime me Ministrinë e Financave	MMPH, MEF
<b>II</b>	<b>Përgatitja e Legjislacionit</b>	
1	Autoriteti kompetent duhet ta paraqesë një sistem i cili do të definojë dhe klasifikojë IMD për të cilat do të vlejë direktiva dhe njëherit të paraqesë Planin për reduktimin	MMPH, MEM, KEK

	e këtyre emetimeve në përputhshmëri me caqet e paraqitura të reduktimit të paraqitura në Shtojcat I (SO <sub>2</sub> ) dhe II (NO <sub>x</sub> ).	
2	Autoriteti kompetent duhet të formulojë një procedurë autorizimi i cili kërkon nga IMD-t ekzistuese dhe ato të reja të specifikuar në Direktivë që të sigurojnë licencat për operim përfshirë këtu edhe periudhën tranzitore.	MMPH
3	Autoriteti kompetent duhet të përdorë metodologjitë monitoruese të paraqitura në Shtojcën VIII, të sigurojë monitorimin e emetimeve gjegjësisht operatorëve duke përdorur metodologjinë e aprovuar dhe sistemim e rezultateve të monitorimit.	MMPH
4	Autoriteti kompetent duhet të disponojë me kapacitet të inspektimit dhe monitorimit në mënyrë që të ketë mundësi të vlerësojë se a janë duke u respektuar kufijtë imituese të emetimit si dhe efektet në ndotjen e ajrit. Shkalla në të cilën vetë-monitorimi i lejohet operatorit si dhe kushtet nën të cilat realizohet ky monitorim duhet specifikuar.	MMPH
5	Të përpilohen tekstet ligjore (drafti) dhe nëse e nevojshme të bëhet amendamenti i tyre.	MMPH
<b>III</b>	<b>Të përgatitet inventari i emetimit</b>	
1	Të përcaktohet emetimi total vjetor	MMPH, MEM, KEK
<b>IV</b>	<b>Rregulla, Monitorimi dhe Fuqizimi</b>	
1	Programi trajnues për stafin e nevojshëm	MMPH
2	Të përpilohet Legjislacioni Sekondar (dekret, rezolutë etj).	MMPH, MEM
3	Të aplikohen kufizimet e emetimit për dyoksid të sulfurit dhe të oksideve të Nitrogenit dhe të pluhurit, ndaras për secilin IMD si dhe përfshirja e tyre brenda autorizimeve të dalura nga Direktiva (Shtojcat III dhe VII)	MMPH, KEK
4	Të kalkulohen vlerat e kufizimit të emetimit për njësitë (kazanët, bojlerët) që përdorin lëndë të ndryshme djegëse dhe për blloqet në rehabilitim, në përputhje me dispozitat e specifikuar	KEK
5	Të aplikohen standardet emetuese për dyoksidin e sulfurit, oksidet e nitrogenit dhe të pluhurit, emetimet	KEK, MMPH



	totale vjetore të dyoksidit të sulfurit, dhe oksidet të Nitrogjenit nga Impiantet (autorizimin e) në Impiantet e Reja Djegëse, përveç atëherë kur lëshimet janë të lejuara në Direktivë.	
6	Të inspektohen dhe monitorohen impiantet dhe të vlerësohen rezultatet e matjeve se sa janë duke iu përmbajtur vlerave limituese të emetimit këto impiante.	MMPH
7	Të aplikohen masat fuqizuese aty ku është e nevojshme, të cilat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese në kuptim të mos përsëritjes.	KEK, MMPH
<b>V</b>	<b>Konsultimi dhe Raportimi</b>	
1	Aty ku ndërtimi i impianteve Djegëse mund të ketë efekte ndërkufitare, të krijohen linja të komunikimit me autoritete kompetente të shteteve fqinje me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe konsultimeve të nevojshme.	MMPH, Qeveria
2	Të sigurohet që operatorët do të informojnë autoritetet kompetente për rezultatet e monitorimit të rregullt dhe masat tjera të parapara në Lejen e Operimit.	MMPH
3	Të përpilohet një sistem raportues dhe një data bazë me qëllim të mundësisë të krijimit të raporteve për nevojat e Qeverisë, publikut dhe partnerëve të Traktatit.	MMPH, MEM
4	Raportim vjetor i rezultateve të programeve (Artikulli 15)	MMPH

### **VËREJTJET**

- 1) Duke marrë parasysh pasojat potenciale ekonomike të paraqitjes së Direktivës për IMD gjithashtu edhe të rëndësisë për mjedisin është shumë me rëndësi që MEM-i dhe MMPH së bashku me KEK-un të jenë të përfshira në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm. Një pikënisje është realizuar që ka të bëjë me këtë projekt, e ai është realizimi i mbledhjeve të rregullta ndërmjet Sekretarëve të përhershëm të të dy ministrive.
- 2) Kosova nuk disponon me sisteme të mjaftueshme të monitorimit të mjedisit në mënyrë që të përcaktojë kualitetin aktual të ajrit. Për momentin, të gjitha shifrat e emetimit janë shtruar përafërsisht përmes kalkulimeve të ofruara nga KEK-u. Për një implementim efektiv, kjo detyrë është me një rëndësi shumë të madhe.

- 3) KEK-u si pronar i termocentraleve nuk ka mundësi që në vazhdimësi të monitorojë emetimet e tij, për arsye të mungesës së pajisjeve për monitorim dhe kontroll. Një periudhë tranzitore, gjatë së cilës do të bëhen investime të duhura në këtë fushë janë më se të nevojshme.
- 4) Kapaciteti institucional për implementim dhe fuqizim të kësaj direktive nuk është i mjaftueshëm. Programe rrënjësore trajnuese të stafit të nevojshëm dhe të inspektoreve janë më se të nevojshme.

#### **4.5 Afati Kohor Indikativ**

Skema në faqen vijuese paraqet afatin kohor indikativ për implementimin e direktivës për IDM në Kosovë. Duhet pasur parasysh se nuk do të ketë kufizime financiare që do të ndikojë në implementimin e afatit kohor.



## **5 Direktiva e Këshillit 79/409/EC të datës 2 Prill 1979 (Direktiva e Zogjve të Egër)**

Qëllimi i kësaj Direktive është që të sigurohet mbrojtje, menaxhim, dhe kontrollimin e zogjve të egër dhe foleve dhe vendbanimeve të tyre brenda Unionit Evropian. Kjo shërben si sigurim që të gjithë zogjtë e egër të pranojnë mbrojtje të nevojshme nga asgjësimi i tyre; gjithashtu vendbanimet e tyre të mbrohen, në veçanti të sigurohet për ata të cenuar dhe migrim të zogjve; gjithashtu ndalimin e mjeteve në shkallë të lartë dhe atyre jo-selektive si dhe eksploatimin komercial të shumicës së zogjve duhet të parandalohet.

Lidhur me Traktatin, Kosova duhet të Implementojë Nenin 4 (2) kur traktati hynë në fuqi. Ky nen paraqet si në vijim:

### **Neni 4**

*1. Speciet të përmendura në Shtojcën I do të jene subjekt i masave për rruajtjen speciale lidhur me mjedisin në mënyrë që të sigurohet për të mbijetuarit e tyre dhe reproduksionin në pjesët e tyre të shpërndarjes  
Lidhur me këtë, duhet të merret parasysh:*

- (a) speciet në rrezik nga zhdukja;*
- (b) speciet të cenuar nga ndryshimet specifike në vendbanimet e tyre;*
- (c) speciet konsiderohen të rrallë për shkak të numrit të vogël të popullatës apo shpërndarjes lokale ristriktë;*
- (d) species tjera kërkojnë vëmendje të posaçme për arsye të natyrës specifike të mjedisit apo vendbanimit të tyre.*

*Trendët dhe variacionet në nivelin e popullatës do të mirën në konsiderim si prapavijë për evoluime.*

*Shtetet Anëtare do të klasifikojnë në veçanti territorin më të përshtatshëm në numër dhe madhësi si pjesë speciale të mbrojtura për rruajtjen e këtyre species, duke marrë parasysh kërkesat e tyre për mbrojtje në pjesët gjeografike në det dhe në tokë ku kjo direktivë aplikohet.*

**2. Shtetet Anëtare do të ndërmarrin masa të ngjashme për migrimin e rregullt të specieve,, jo të listuar në Shtojcën I, duke pasur parasysh pjesët gjeografike te detit dhe në tokë ku kjo Direktivë aplikohet, me respekt të mbarështimit të tyre, ndërrimin e puplave dhe pjesëve dimërore dhe pikave përqendruar përgjatë rutave të tyre të migrimit. Për fund, Shtetet Anëtare duhet ti kushtojnë vëmendje mbrojtjes së vendeve me lagështi dhe në veçanti vendeve me lagështi të rëndësisë ndërkombëtare.**

Implementimi i Nenit 4 (2) kërkon nga qeveria të merr masa speciale për rruajtjen e vendbanimeve dhe mjedisit të species së zogjve të egër posaçërisht të atyre që varen nga lagështia e tokës të rëndësisë ndërkombëtare, për sigurim të të mbijetuarve të tyre dhe reproduksionit në pjesët e tyre të shpërndarjes.

Implementimi i këtij Neni të Direktivës bie në MMPH. Një inventar duhet të tregojë se cila specie – nëse ndonjë – bie nën këtë direktivë. Nëse aty ka species që kanë nevojë për mbrojtje speciale nën këtë direktivë, qeveria duhet të përcaktojë Pjesët Speciale të Mbrojtura. .

Rreth kësaj çështje, MEM-i nuk mundet të jetë udhëzues për MMPH-në, dhe për çfarë do propozimi në të ardhmen e afërt do të pritet nga MMPH-ja.

## **6 Konkluzionet**

- Kërkesa për implementimin e Direktivës së NMV-së tanimë është arritur në Kosovë.
- Direktiva e Zogjve të Egër duhet ti lihet MMPH-së
- Implementimi i IMD-së është kryesisht i komplikuar. Jo vetëm kostot ekonomike kuptimplote janë përfshirë, por gjithashtu nga perspektiva e zbatimit të menaxhimit dhe implementimit është i vështirë.
- Pa një vlerësim të plotë të kostos ekonomike të implementimit të Direktivës së IMD-së (nën skenari të ndryshme) për KEK-un, zhvillimi i planit real implementues nuk është i mundshëm. Grupi Punues, përfshirë KEK-un duhet të iniciojë studim diagnostikim në mënyrë që ti përcaktojë nivelet aktuale të emetimit dhe kostot ekonomike të pajisjes për pakësimin e ndotësve të ndryshëm nën skenar të ndryshëm të zhvillimit.
- Prioriteti më i lartë është instalimi i pajisjes për monitorim të emetimit në KEK.
- Aktualisht, stafi i trajnuar në dispozicion është i pamjaftueshëm. Andaj, duhet një vëmendje e posaçme duhet ti kushtohet trajnimeve adekuate për stafin e ardhshëm të domosdoshëm të të gjitha organizatave relevante.

## Shtojcat

## Shtojca I: KREU I MJEDISIT TË TKE-EJL

### Kapitulli III – ACQUIS MBI MJEDISIN

#### *Neni 13*

Çdo Palë Kontraktuese do të zbatojë *acquis communautaire* mbi mjedisin, në përputhje me afatet për zbatimin e atyre masave që janë parashtruar në Shtojcën II.

#### *Neni 14*

Palët pranojnë rëndësinë e Protokollit të Kiotos. Çdo Palë Kontraktuese do të bëjë përpjekje për ta miratuar atë.

#### *Neni 15*

Palët pranojnë rëndësinë e rregullave të parashtruara në Direktivën 96/61/EC të Këshillit Europian të 24 Shtatorit 1996, lidhur me parandalimin e ndotjes së integruar dhe kontrollin. Çdo Palë Kontraktuese do të bëjë përpjekje për ta zbatuar atë Direktivë.

#### *Neni 16*

Pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati, ndërtimi dhe shfrytëzimi i impianteve të rinj të prodhimit do të bëhet në përputhje me *acquis communautaire* mbi mjedisin.

#### *Neni 17*

“*Acquis communautaire* mbi mjedisin”, për qëllime të këtij Traktati do të thotë (i) Direktiva 1985/337/EEC e Këshillit, e datës 27 Qershor 1985, “Mbi vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin të disa projekteve publike dhe private” siç është amenduar nga Direktiva 97/11/EC e Këshillit e datës 3 Mars 1997 dhe Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 26 Maj 2003, (ii) Direktiva 1999/32/EC e Këshillit e datës 26 Prill 1999 “Mbi zvogëlimin në përmbajtje të sqfurit tek disa lëndë djegëse të lëngshme dhe Direktiva amenduese 93/12/EEC, (iii) Direktiva 2001/80/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2001, “Mbi kufizimin e lëshimeve në ajër të disa ndotësve prej impianteve të mëdhenj me djegie, dhe (iv) Neni 4 (2) i Direktivës 79/409/EEC të Këshillit të datës 2 Prill 1979 “Mbi ruajtjen e zogjve të egër”.

#### *Neni 18*

Dispozitat dhe Masat e marra në këtë Kapitull do të zbatohen vetëm për Rrjetin e Energjisë.

## **Shtojca II: Afati Kohor për implementimin e Acquis mbi Mjedisin**

1. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë Direktivën e Këshillit 85/337/EEC të datës 27 Qershor 1985 për vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private për mjedis, siç është rregulluar nga Direktivat e Këshillit 97/11/EC të datës 3 Mars 1997 dhe Direktivës 2003/35/EC të Këshillit të Parlamentit Evropian të datës 26 Maj 2003, me hyrje në fuqi të këtij Traktati.
2. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë Direktivën e Këshillit 1999/32/EC të datës 26 Prill 1999, lidhur me reduktimin e përmbajtjes së Sulfurit në karburantet të caktuara të lëngshme dhe amendimin/korrigjimin e Direktivës 93/12/EEC, deri me 31 Dhjetor 2011.
3. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë Direktivën 2001/80/EC të Këshillit të Parlamentit Evropian të datës 23 Tetor 2001 mbi limitimin e emetimeve të ndotësve të caktuar në ajër nga Impiantet e Mëdha Djegëse, deri me 31 Dhjetor 2017.
4. Secila Palë Kontaktuese do të implementojë Nenin 4(2) të Direktivës 79/409/EEC së Këshillit të datës 2 Prill 1979 për mbrojtjen e zogjve të egra, me hyrje në fuqi të këtij Traktati.



## Shtojca III: MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT MEM-MMPH

### MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

Ndërmjet

Ministrit të Energjisë dhe Minierave

Dhe

Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Duke ditur se sektori i energjisë dhe minierave shkakton probleme të rënda mjedisore;

duke ditur se që të dy sektorët janë në një periudhë ekonomike kalimtare dhe ka nevojë për investime më të mëdha për vazhdueshmëri ekonomike, teknike e mjedisore;

duke ditur se rëndësia e dhënë e sektorit është e domosdoshme të barazojë politikën ekonomike dhe politikën mjedisore për të siguruar vazhdueshmëri afatgjate të sektorëve;

duke ditur se bashkëpunimi mes MEM dhe MMPH në sferat e shqetësimeve të ndërsjella do të rrisë efikasitetin e politikës së energjisë po ashtu edhe të politikës mjedisore të Kosovës;

duke ditur se bashkëpunimi i tillë duhet të futet në marrëveshje zyrtare.

### **Pranuar nga përfaqësuesit e MEM dhe MMPH:**

1. Sekretari i Përhershëm në MEM-it dhe i MMPH-së do të mbledhet në çdo tremujorësh për të diskutuar gjendjen aktuale të punëve në bashkëpunimin e MEM dhe MMPH dhe të jepet udhëheqja e funksionimit nga ana e zyrtarëve përgjegjës.
2. Sekretarët e Përhershëm, i MEM-it dhe i MMPH-së, do të obligojnë Departamentin për Strategji dhe Zhvillim në MEM dhe Departamentin e Mjedisit në MMPH që përmes zyrtarëve të tyre të caktuar të zhvillojnë bashkëpunimin në sferat përkatëse, sipas kësaj Marrëveshjeje.
3. Shtojca I e bashkangjitur përkufizon parimet themelore për bashkëpunim dhe propozon sferat e mundshme për bashkëpunim.

Data: \_\_\_\_\_

Nenshkruar: \_\_\_\_\_

Z. \_\_\_\_\_

Z. \_\_\_\_\_

Sekretari i Përhershëm

Sekretari i Përhershëm

Ministria e Energjisë dhe Minierave

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit  
Hapësinor

## **Shtojca IV: Sugjerimet për bashkëpunim struktural në mes të MEM-it dhe MMPH-së**

Synim kryesor për bashkëpunim është të përforcojë dhe bashkërendojë politikat mjedisore dhe politikat e energjisë të Kosovës bazuar në kompetencat dhe obligimet e të Ministrive, MEM dhe MMPH dhe në pajtueshmëri me Planin Zhvillimor të Qeverisë.

Mundësitë dhe arsyet për vendosjen e bashkëpunimit ndër sektorial, në mes të Ministrisë së Energjisë dhe Minerave (MEM) dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), do të jenë si më poshtë:

- Sektori i energjisë i shoqëruar me minierat e linjitet është një ndër sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, ndonëse në të njëjtën kohë shkakton problemet mjedisore më të mëdha të cilat kryesisht janë të trashëguara nga e kaluara e operatorëve të termocentraleve;
- Mungesa e investimeve për mirëmbajtjen e termocentraleve dhe të minierave në të kaluarën ka shkaktuar probleme të rënda mjedisore, të cilat mund të zgjidhen me angazhime të përbashkëta efektive, të Qeverisë së Kosovës (përmes MEM dhe MMPH) dhe donatorëve. Kjo gjithashtu kërkon investime për masat mjedisore. Prandaj, problemet mjedisore duhet të vendosen në “agjendën” e të gjithë pjesëmarrësve për të siguruar qëndrueshmëri afat-gjate ekonomike dhe mjedisore të kësaj fushe;
- Përafrimi me legjislacionin e BE-së, veçanërisht në periudhën e tranzicionit të tanishëm, është një proces i komplikuar, të cilin proces bashkëpunimi në mes dy ministrive do ta ndihmojë dhe lehtësojë shumë.

### **Vendosja e bashkëpunimit struktural**

Për të sistemuar procesin e bashkëpunimit propozohet krijimi i marrëdhënieve të rregullta të punës në nivele të ndryshme në bazë të hierarkisë, si vijon:

1. Struktura e nivelit të lartë (Sekretari i Përgjithshëm ose Zv. Ministri) do të mbledhen në çdo tre muaj për të diskutuar rezultatet e grupeve punuese, dhe do të zërthejë çfarëdo çështje apo problem të paraqitur, të përkufizojnë ose të vërtetojnë çështjet specifike që janë diskutuar në nivelin ministror/qeveritar. Rezultatet nga këto takime raportohen drejtpërsëdrejti te ministrat përkatës.
2. Grupi Punues ndër sektorial (GP), në nivel të departamenteve, mban takime të rregullta mujore, për tema specifike. GP raporton rregullisht në takimet e Nivelit të Lartë. (në ministrinë e veta).

### **Sugjerimet për Lëmit e bashkëpunimit**

- Mbajtja e takimeve me Departamentin e Mjedisit të KEK-ut me qëllim që të arrihet: 1) Përfitimi i pasqyrës së qartë mbi mundësitë dhe detyrimet për masat mjedisore, 2) Identifikimi i mundësive për regjim tranzicional

duke respektuar normat dhe standardet e vendosura mjedisore (Planet e Veprimit MEM dhe MMPH), dhe 3) Vendosja e strukturës raportuese.

- Shkëmbimi i pikëpamjeve dhe planeve për mbrojtjen e mjedisit, për implementim të strategjisë së energjisë, duke bashkërenditur dhe përkrahur zhvillimin e energjisë dhe masat për veprimet në mjedis.
- Shkëmbimi i informatave (bazës së të dhënave) mjedisore që ndërlidhen me ato të prodhimit të energjisë. Kështu arrihet synimi, në të ardhmen, që të krijohet një bazë e të dhënave (DB) e përbashkët për energji dhe mjedis.
- Rishikim/rishqyrtim i përbashkët i periudhës kalimtare dhe çështjet lidhur me zhvillimin e mihjeve në të ardhmen.
- Paraqitja e projekteve të përbashkëta për energji/mjedis para donatorëve.
- Pjesëmarrja e përbashkët në studimet/projektet për zhvillimin e Sektorit të Energjisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.
- Bashkëpunojnë për implementimin e Traktatit të Energjisë, veçanërisht mbi Acqui për mjedis edhe për çështje tjera me interes të ndërsjellë.

#### **Çështjet e sugjeruara për bashkëpunim, sipas projektit të AER-it**

- Pjesëmarrja edhe e MMPH-së së bashku me MEM-in në aktivitetet përkatëse të projektit të AER-it, siç është efiçienca e prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë dhe programi i zhvillimit të burimeve të ripërtëritëse, rishqyrtimi i planit për implementimin e Strategjisë së energjisë, zhvillimi i Planit të Veprimit për aprovimin e Direktivave të BE-së –Impiantet e Mëdha të Djegies dhe Karburantet e Lëngëta;
- Pjesëmarrja në seminarët përkatëse për programin e përgjithshëm në Projektit e trajnimit, si për shembull–Kosova dhe ndryshimet klimatike (inventari-gazrat serrë, sipas Kyoto Protokollit, obligimet dhe përparësitë, etj).
- Paraqitja e udhëzimeve në seminarët përkatëse mbi temat si Ligji për Mjedis, VNM, përafrimi me Legjislacionin e BE-së për mjedis (cilat janë problemet kryesore, cilat janë veprimet e domosdoshme, afati kohor, etj).
- Përcaktimi i fushave të veçanta për ndërhyrjen e ekspertëve të projektit, konkretisht eksperti për mjedis, eksperti për efiçasitet të energjisë.

## Shtojca V: Shënim i shkurtër Sekretarit të Përhershëm të MEM

**Tema:** Statusi i Memorandumit të Mirëkuptimit me MMPH-së

- Të Premten me 13 Tetor është mbajtur takimi i punës në mes të MEM-it dhe MMPH-së, pasuar me rezultate pozitive nga takimet e mëparshme në mes të dy Sekretarëve të Përhershëm.
- Gjithashtu është përgatitur dokument diskutimi si një nga obligimet të paraqitura në Traktat të Energjisë. Kjo ka të bëjë me implementimin e Direktivës së Impianteve të Mëdha Djegëse në Kosovë. Kjo është diskutuar brenda në MEM dhe pastaj dorëzuar MMPH-së për komente në takimin e së Premtes.
- MMPH-ja ka informuar MEM-in që Rregullat janë përgatitur nga MMPH-ja mbi Impiantet e Mëdha Djegëse. MMPH-ja do ti dërgojë informacionet në MEM.
- Pas pranimit të këtij informacioni, MEM-i, dhe MMPH-ja mund të diskutojnë për procedurën që kjo të bëhet një dokument që do të ishte e pranueshme për të dy ministrinë.
- Pas miratimit të këtij dokumenti kjo mund të përdoret dhe ti dorëzohet KEK-ut pasi që ata duhet ti përmbushin në mënyrë ultimative rregullat, dhe nevojën për të bërë investime kuptimplote të rëndësishme.
- MMPH-ja gjithashtu ka informuar MEM-in rreth problemeve me implementimin e kërkesave tjera të paraqitura në Traktat: rregullën mbi përmbajtjen e sulfurit të karburanteve të caktuara të lëngëta. Pasi që të gjitha karburantet e lëngëta janë të importuara në Kosovë, Ministria e Industrisë dhe Tregtisë luan një rol të rëndësishëm. MMPH-ja ka bërë draft-rregulloren, por MTI preferon të adoptoj rregulloren e vet për këtë lëmi. Si e tërë kjo nuk është procedurë korrekte. MMPH-ja është përgjegjëse për këtë rregullore pasi që kjo është pjesë e kornizës së punës për mbrojtjen e ajrit. Gjithashtu kjo aplikohet në shumicën e vendeve të BE-së. Meqë legjislacioni lidhur me këtë temë duhet të përgatitet nga MMPH-ja, atëherë implementimi mund të delegohet nga MTI (implementimi lidhur me mostrat dhe analizat e karburanteve të lëngëta dhe nevojën që të bëhet nga laboratorit i certifikuar dhe stafi i trajnuar).
- Është miratuar që kjo gjendje të ngritet në vëmendjen tuaj me ide të operimit bashkërisht në këtë temë drejt MIT. MMPH-ja gjithashtu ka premtuar të dërgojë informatën mbi rregullat e tyre të MEM-it.
- MMPH-ja gjithashtu ka kërkuar nga MEM-i që ta vështrojë edhe një herë Memorandumin e Mirëkuptimit për komente. Pas kësaj procedura për nënshkrim mund të fillojë.

13 Tetor, 2006  
MEM-Departamenti i Mjedisit